

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Tonka Berishaj dhe Mejreme Memaj, anëtare të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.H., për shkak të veprave penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1.4 dhe 1.5 e lidhur me nenin 28 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesat e prokurorit të PTH në Mitrovicë, përfaqësueses së autorizuar të dëmtuarit av.K-B.P. dhe të mbrojtësit të të akuzuarit S.H., av.A.L., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.916/2013, të dt.29.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datën 15.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përfaqësueses së palës së dëmtuar N.Rr., av. K. B. –P. dhe mbrojtësit të të akuzuarit S.H., av. A.L., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.916/2013, të dt.29.09.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore-DKR në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.916/2013, të dt.29.09.2017, të akuzuarin S.H., e ka shpallur fajtor për veprat penale vrasje në tentativë nga neni 178 e lidhur me nenin 28 të KPRK, veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK dhe është gjykuar për veprën penale në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4(katër)viteve, ndërsa për veprën penale në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1(një)viti, e më pastaj me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 4(katër) vite e 6(gjashtë)muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.06.03.2013 e deri me dt.06.04.2013.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 447.73Euro, në emër të ekspertizës psikiatrike si dhe 50 Euro, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Nga i akuzuari është konfiskuar arma e markës AK047, me numër serik 01799 të kal.7.62mm, me një karikator.

I dëmtuari N.Rr., për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Prokuroria Themelore-DKR në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

-Përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar av.K-B.P., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim merititor.

-Mbrojtësi i të akuzuarit S.H., av.A.L., për shkak të të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovoj dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta dënon më pakë apo të anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta kthejë në rigjykim.

Prokurori i Shtetit, me parashtrësën PPA/I.nr.455/2017, të dt.20.10.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar, ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë dhe e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar N.Rr. dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ku i akuzuari S.H., të shpallet fajtor dhe të dënohet për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.4 dhe 1.5 lidhur me nenin 28 të KPRK, e pastaj për këtë vepër penale dhe veprën penale- mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, ti shqiptojë një dënim adekuat unik më të lartë me burgim apo aktgjykimin ta anulojë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit S.H., meqë nuk qëndrojnë pretendimet e cekura si në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, në të cilën prezantuan: përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar av.K.B.-P., e cila bëri disa sqarime lidhur me pretendimet ankimore, i dëmtuari N.Rr. i cili i mbështeti pretendimet e përfaqësuese së tij, mbrojtësi i të akuzuarit S.H., av. A.L., i cili po ashtu bëri sqarime lidhur me pretendimet ankimore dhe i akuzuari S.H., i cili e mbështeti ankesën e mbrojtësit. Prokurori i Apelit në Prishtinë edhe pse është njoftuar me rregull nuk mori pjesë në seancën e kolegjit, andaj Gjykata e Apelit seancën e kolegjit e mbajti në mungesë të tij konform nenit 390 par. 4 të KPPK.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPP lidhur me nenin 370 pika 7 të KPPK, paragrafit 2, nën par. 2.1 të nenit 384 të KPP lidhur me nenin 3 dhe 7 të KPP, duke theksuar se arsyet mbi faktet vendimtare përkitazi me dashjen e të akuzuarit janë plotësisht të paqarta dhe ekziston një kontradiktë e konsiderueshme midis asaj që paraqitet në arsyetim të aktgjykimit dhe thënieve në procesverbal me ç'rast i referohet konstatimit në faqen 9 të arsytimit të aktgjykimit ku konstatohet: trupi gjykues vlerëson se i akuzuari ka pasur motiv që ta privoi nga jeta të dëmtuarin dhe për këtë ka shtënë në drejtim të tij...”, ndërsa nga deklarata e të dëmtuarit N. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor rezulton se i akuzuari së pari ka gjuajtur në drejtim të dëshmitarit A. 4 herë e pastaj ka gjuajtur në drejtim të tij nga mbrapa, ndërkaq nga provat e shqyrtuara vërtetohet se hyrjet e plumbave ishin nga ana e majtë e jo nga mbrapa. Kështu, sipas tij, gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin gjyqësor i vërteton elementet të rëndësishme që i konstaton në procesverbal, mirëpo në aktgjykim nuk arsyeton se pse nuk i merr për bazë elementet qenësore të cilat i ka vërtetua. Po ashtu i referohet edhe rëndësisë, besueshmërisë dhe fuqisë provuese të provave duke ju referua faktit se gjykata e shkallës së parë lidhur me deklaratat e dëshmitarëve ka pasur qasje të pjesshme duke ua falë besimin pjesërisht edhe pse deklaratat e tyre ishin plotësisht kundërthënëse, andaj ato është dashtë të merren si një provë dhe përfundimet e veta ti bazoi në faktet e provuara e jo në supozime.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dispozitivi i aktgjykimit, si dhe aktgjykimi i ankimuar në tërësi është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare, të kësaj çështje juridiko-penale. Kështu, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është i plotë dhe i kuptueshëm, me asgjë të njëjtin nuk e bënë dubioz. Është bërë përshkrimi i duhur i veprimeve inkriminuese të akuzuarit duke dhënë edhe tiparet dhe faktet vendimtare për to. Në arsytimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin dhe analizën e provave të administruara, gjatë shqyrtimit gjyqësor në pajtim me dispozitën e nenit 361 të KPPK dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta. Pra, për qëndrimin e vlerësimit të saj, përkitazi me provat e administruara janë dhënë arsye të hollësishme. Edhe mbrojtja e të akuzuarit ka qenë objekt i vlerësimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe është vlerësuar si çdo provë tjetër, në pajtim me nenin 361 të KPP.

Prandaj, qasja ndaj fakteve vendimtare-relevante është i drejtë dhe i ligjshëm, asnjë fakt nuk ka ngelur mbetur dubioz ose i pavërtetuar. Kështu konkludimet të cilat i ka nxjerr gjykata e shkallës së parë janë të drejta sepse kanë mbështetje në provat e administruara dhe jo vetëm që janë drejtë të vërtetuara, por në mënyrë të drejtë dhe të plotë janë arsyetuara.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Përkritazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në ankesën e Prokurorit të PTH në Mitrovicë pretendohet se faktet vendimtare të kësaj çështjeje nuk janë vërtetuar drejtë. Kështu gjykata e shkallës së parë duke mos ia falë besimin deklaratave të dëshmitarëve A. S. dhe N.Rr., të cilët pohojnë se i akuzuari së pari ka shtënë në drejtim të dëshmitarit A. e pastaj në drejtim të dëmtuarit N. gabimisht ka gjetur se i akuzuari me veprimet e tija inkriminuese ka vënë rrezik edhe jetën e dëshmitarit A. Sinani, sepse ky dëshmitarë qartë ka deklaruar se i ka dëgjuar disa të shtëna të cilat kanë shkuar mbi kokën e tij, ka ndal traktorin dhe është fsheh pas rrotës së traktorit.

Ndërkaq në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit theksohet se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka bartë përmbajtjen e deklaratave të palëve duke dhënë vetëm arsyetim të pjesshëm se cila fakteve u falë besimin e cilave jo dhe po të ishte aprovuar propozimi i mbrojtjes për rekonstruimin e vendit të ngjarjes do të ishin vërtetuar plotësisht faktet lidhur me pozitën në cilën ishte i dëmtuari N., a ka pasur mundësi ta vëzhgoi ngjarjen dhe a ka qenë i penguar nga ndonjë pengesë që të vëzhgoi.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate edhe pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë .

Sipas shkresave të lëndës rezultojnë si jo kontestuese këto fakte: se i akuzuari dhe i dëmtuari N.Rr. kanë pasur mosmarrëveshje edhe para ngjarjes kritike. Ditën kritike i dëmtuari ishte duke qarkulluar në rrugën e fshatit ..., drejtimi për në ... me traktor duke i dërguar dru V.B. së bashku me dëshmitarin A. S., i cili ishte po ashtu me traktor pas të dëmtuarit. Nuk është kontestues fakti se kur ka arritur i dëmtuari në vendin e quajtur ‘Të mulliri’ i akuzuari i fshehur pas disa shkurave, me pushkë automatike ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarit me ç’rast e qëllon në të dy këmbët, pikërisht në regjionin e kërcirit të këmbës së djathtë dhe në regjionin e nyjës së shputës së këmbës dhe kërcirit të këmbës së majtë, lëndime këto që kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Në tërë këtë ngjarje kontestuese janë faktet se i akuzuari a veproi me dashje për ta privuar nga jeta të dëmtuarin N., dhe fakti se me veprimet e tij e ka rrezikuar me dashje jetën edhe të dëshmitarit A. S. si pretendon Prokurori.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari me dashje ka tentuar me e privuar nga jeta të dëmtuarin N.Rr., janë të drejta, sepse nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit vërtetohet se pas mosmarrëveshjes që kishte i akuzuari atë ditë me të dëmtuarin, shkon në shtëpi, merr armën, pret anë rrugës deri sa vjen i dëmtuari dhe nga arma –pushka automatike AK 47 ka shtënë në drejtim të traktorit të cilin e ka drejtuar i dëmtuari dhe i shkakton lëndime trupore të përshkruara si më lartë. Prandaj, duke pas parasysh dëmtimet në traktor nga arma e zjarrit (sipas ekzaminimit të

traktorit) dhe dëmtimet që ka pësuar i dëmtuari, pa dyshim vërtetohet edhe dashjen e tij për ta privuar nga jeta të dëmtuarin. Po të kishte pasur për qellim vetëm për ta frikësuar të dëmtuarin, atëherë edhe veprimet e tija nuk kishin pasur pasoja pasi që ka pasur mundësi të shtënë mbi e jo në traktor.

Në anën tjetër, me asnjë provë konkrete nuk është vërtetuar se i akuzuari ka shtënë në drejtim të dëshmitarit A. S. e as fakti se duke shtënë në drejtim të dëmtuarit N. ka vënë në rrezik jetën e këtij dëshmitari sepse, ashtu si deklaroi i dëmtuari N. dhe dëshmitari A. e që vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, i akuzuari ka shtënë nga ana e majtë të traktorit të dëmtuarit, nga distanca prej 4-5 metra, kurse dëshmitari me traktorin e tij ka qenë në largësi prej 30 metrave pas traktorit të dëmtuarit N. . Pra i akuzuari ka shtënë në mënyrë ballore në traktorin e të dëmtuarit dhe nuk ka pasur asnjë mundësi për ta rrezikuar dëshmitarin A. S., si drejt ka konkluduar edhe gjykata e shkallës së parë.

Nga arsyet e cekura si më lartë nuk janë aprovuar pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe se gjithë ajo që është thënë në aktgjykimin e ankimuar përkitazi me gjendjen faktike në tersi mbështetet nga kjo Gjykatë, që do të thotë se i akcepton të gjitha arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë përkitazi me çështjen e motivit të veprës penale, ecurinë se si është zhvilluar ngjarja kritike si dhe rrethanave pse nuk janë aprovuar teza e akuzës dhe teza e mbrojtësit të të akuzuarit.

Meqen se, aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, drejtë ka aplikuar ligjin penal kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha tiparet e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe veprës penale –mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK.

Vendimi për dënim.

Në ankesën e përfaqësueses së autorizuar të palës së dëmtuar përkitazi me vendimin për dënimin theksohet se është bërë shkelja e ligjit penal në favor të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë me rastin e shpalljes fajtor të njëjtit për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 174 lidhur me nenin 28 të KPRK, gjë që ka ndikuar në shqiptimin e dënimit më të butë, mirëpo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret dhe kufizimet e të dëmtuarit përkitazi me ankimimin e aktgjyimit për bazat tjera për të cilat mund të ankimohet aktgjykimi, pretendon se ka vend për ndryshimin e aktgjyimit dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim meritor.

Në ankesën e mbrojtësit përkitazi me vendimin për dënimin theksohet se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i lartë sepse pala e dëmtuar me sjelljet e tij dhe duke e kërcënuar të akuzuarin që e ka shprehur edhe para trupit gjykues, ka ndikuar në ndërmarrjen e veprimeve nga i akuzuari.

Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar të gjitha rrethanat e rastit konkret, rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat përkitazi me personalitetin e

të akuzuarit. Prandaj, duke e pasur parasysh posaçërisht shkallën e intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së. Për një dënim më të ashpër, siç pretendon përfaqësuesja e palës së dëmtuar, gjegjësisht një dënim më të butë, siç pretendon mbrojtja, nuk janë plotësuar kushtet ligjore, aq më parë kur me ankesa nuk theksohen rrethana të tilla që do të arsyetonin një dënim më të ashpër, gjegjësisht më të butë.

Nga çka u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.485/2017 i datës 15.11.2017

Procesmbajtësi:	Anëtarët e kolegjit:	Kryetari i kolegjit:
Syzana Goxhuli	Tonka Berishaj_____	Xhevdet Abazi
	Mejreme Memaj _____	